



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Data: 11 .04.2022

Drejtuar: SHPRESA - AL sh.p.k, me NUIS K31321021N , me adresë Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center", Pallati Nr.11, Kati 2 , Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me 1 (një) operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-20852-02-28-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Inerte”, me afat lëvrimi nga lidhja e kontratës /kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër, me fond limit: 44.511.000 (dyzet e katër milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 07.03.2022, Numri 29

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “KEGLI-DURI” sh.p.k, me NUIS K94016202U, me vlerë të ofruar prej 41.258.200 (dyzet e një milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k. me NUIS K41416033P, me vlerë të ofruar prej 44.372.020 (dyzet e katër milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë njëzet) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k, me NUIS K51501008J, me vlerë të ofruar prej 33.333.333 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “SHPRESA – AL” sh.p.k, me NUIS K31321021N, me vlerë të ofruar prej 43.948.760 (dyez e tre milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “KEGLI-DURI sh.p.k, me NUIS K94016202U

Arsyet e skualifikimit janë:

- Nuk përmbush pikën 2.1 gërma a) të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”*
- Operatori nuk ka deklaruar në pjesën e II, rubrika A të shtojcës 8, emrin e personit (personave) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtor ose mbikëqyrës, aksioner ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik sipas parashikimit të pikës ç) tek kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit .
- Operatori nuk ka deklaruar në pjesën e III, rubrika B të shtojcës 8, listën me të dhënat konkrete të makinerive dhe mjeteve që disponon.
- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda vitit 2022, të lëshuar nga një laborator i certifikuar nga organet kompetente të shtetit shqiptar.”* pasi nuk ka paraqitur raport analizë ose raport testimi për zërin çimento.
- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë impiant prodhimi dhe përpunimi të inerteve në pronësi/me qera ose të paraqesë kontratë furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e marrëveshjes kuadër. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B), e vlefshme.”* pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri për zërin çimento.

2.Operatori Ekonomik “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k, me NUIS K41416033P

Arsyet e skualifikimit janë:

- Nuk përmbush pikën 2.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 ;b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3” pasi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e mësipërme.
- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (01.03.2022) per procedurën e prokurimit me objekt “Blerje inerte”, me numër REF-20852-02-28-2022, përkatësisht brenda periudhës 01.03.2019-01.03.2022. Furnizimet e paraqitura nga operatori ekonomik janë kryer përpara periudhës së sipërcituar.

- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë impiant prodhimi dhe përpunimi të inerteve në pronësi/me qera ose të paraqesë kontratë furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e marrëveshjes kuadër. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B), e vlefshme.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri per zerin çimento.

3. Operatori Ekonomik “S I R E T A 2F” sh.p.k, me NUIS K51501008J

- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (01.03.2022) per proceduren e prokurimit me objekt “Blerje inerte”, me numër REF-20852-02-28-2022, përkatësisht brenda periudhës 01.03.2019-01.03.2022. Furnizimet e paraqitura nga operatori ekonomik janë kryer përpara periudhës së sipërcituar.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi*” pasi në analizën e çmimeve për zërat objekt prokurimi, operatori ekonomik e ka përlllogaritur pagën orare, jo sipas VKM-së Nr. 1025, date 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik a juridik, vendas ose i huaj dhe as sipas Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik me Nr.2652/2 Prot., datë 04.05.2021.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “SHPRESA – AL” sh.p.k, me NUIS K31321021N, me vlerë të ofruar prej 43.948.760 (dyzet e tre milion e nëntëqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.